



Dugajevë, 29.03.2025

DOKUMENTI I RREGULLAVE PËR MENAXHIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË KISHËS "SHËN NËNË TEREZA" NË DUGAJEVË

Ky dokument përshkruan rregullat dhe detyrimet e përfaqësuesve dhe anëtarëve të grupeve të ndryshme që do të jenë të përfshirë në projektin e ndërtimit të Kishës "Shën Nënë Tereza" në Dugajevë. Të gjithë personat dhe grupet përkatëse janë të detyruar të respektojnë këto rregulla për të siguruar një proces të drejtë, transparent dhe të ligjshëm.

1. PËRDITËSIMI I PROGRESIT TË PROJEKTIT DHE I INFORMACIONEVE

Të gjitha përditësimet mbi zhvillimet e projektit, përfshirë ecurinë e punimeve, ngjarjet dhe aktivitetet e ardhshme, do të publikohen në faqen zyrtare të Kishës së Nënës Terezë.

Të gjitha mbledhjet, qoftë offline ose online, do të protokollohen dhe protokollet e mbledhjeve do të publikohen në faqen e internetit pas çdo mbledhjeje për të siguruar transparencë të plotë.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E GRUPEVE DHE TË ANËTARËVE TË TYRE

Stafi Organizativ (Organizimi, Koordinimi dhe gjetja e Donatorëve) – 3 anëtarë

- Organizimi dhe koordinimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura me ndërtimin e Kishës.
- Gjetja e donatorëve dhe sigurimi i mbështetjes financiare për projektin.
- Organizimi i mbledhjeve për të diskutuar përparësitë dhe sfidat e projektit.
- Promovimi i harmonisë dhe mirëkuptimit mes grupeve të përfshira.
- Organizimi dhe mbajtja e takimeve të rregullta offline dhe online për të shqyrtuar progresin dhe për të adresuar shqetësimet e mundshme.
- Organizimi i takimeve jo të rregullta nëse njëra nga këto dy grupe e kërkon.

Komisioni i Financave dhe i monitorimit të ndërtimit – 5 anëtarë

- Mbikëqyrja dhe monitorimi i procesit të ndërtimit.
- Miratimi i të gjithë anëtarëve për tërheqjen e fondeve nga llogaria bankare.
- Sigurimi që procesi i ndërtimit të zhvillohet sipas standardeve të larta dhe ligjit.
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret ndërtimore dhe ligjore.
- Raportimi i progresit të ndërtimit dhe informimi i stafit organizativ.



3. RREGULLAT DHE PARIMET PËR DONACIONET DHE TRANSPARENCËN

- Të gjitha donacionet duhet të depozitohen vetëm në llogarinë bankare të Kishës së Shen Nënës Terezë në Dugajevë, Kosovë.
- Tarifat bankare të donatorëve mund të zbriten nga shuma e dhuruar, përveç nëse donatori ka mundësi të paguajë ato tarifa vetë.
- Emri i donatorit, vendi, shuma dhe data e dhurimit duhet të jenë të qarta dhe të plota për çdo donacion, me qëllim që të shmanget çdo keqkuptim dhe të sigurohet transparencë e plotë.
- Çdo aktivist i këtyre grupeve duhet të punojë me transparencë dhe sinqeritet, duke kontribuar që projekti të zhvillohet në harmoni, paqe dhe bashkëpunim, dhe të sigurohet mirëkuptimi i plotë mes të gjithë komitetit.

Përfaqësuesit e Stafit Organizativ (3 anëtarë)

- 1: Dom Ambroz Demaj
- 2: Marjan Gojani
- 3: Kolë Berisha

Përfaqësuesit e Komisionit të Ndërtimit (5 anëtarë)

- 1: Dom Amorz Demaj
- 2: Sokol Syla
- 3: Dedë Gojani
- 4: Nikollë Nikprelaj
- 5: Riqard Gjonaj

Data: _____